

26-07-2023

4812

Shpallje Publike

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, Seksionin V Pikën 3 (c) të Rregullores së KEK-ut Sh.a, dhe nevojave të paraqitura për plotësimin e disa vendeve të lira të punës në Divizionet e KEK-ut, Divizioni i Burimeve Njerëzore, më 26.07.2023 publikon shpalljen për pozitat e mëposhtme:

Saldues elektrik (22 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

- Kryen punët e saldimeve elektrike në bazë të urdhëresave dhe udhëzimeve të lëshuara nga inxhinierët përgjegjës
- Respekton në mënyrë rigorozë udhëzimet për mirëmbajtje, të cilat janë përgatitur nga inxhinieri përgjegjës.
- Është përgjegjës për mirëmbajtjen e aparateve të saldimit dhe pajisjeve përcjellëse
- Respekton orarin e punës si dhe me disiplinë kryen punët e dhëna nga prijësi i ekipit apo ndonjë epror tjetër në sistemin ku është caktuar të punoi. Zbaton të gjitha rregullat e sigurisë
- I përgjigjet çdo kohe thirrjes për intervenim dhe të vazhdoj punën sipas nevojës edhe pas ORR. Kryen edhe pune tjera me kërkesën e eproreve të tij

Kualifikimet

- Të jetë saldues i certifikuar sipas standardit 9606-1 për saldim me hark elektrik. Të ketë përfunduar shkollën e mesme, të jetë i certifikuar si dhe të ketë një (1) vite përvojë pune në profesion. Aftësi profesionale, Aftësi që të arrij afate kohore. Aftësi për pune ekipore.

Saldues me Argon (6 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

- Kryen punët e saldimeve me argon në bazë të urdhëresave dhe udhëzimeve të lëshuara nga inxhinierët përgjegjës.
- Respekton në mënyrë rigorozë udhëzimet për mirëmbajtje, të cilat janë përgatitur nga inxhinieri përgjegjës.
- Është përgjegjës për mirëmbajtjen e aparateve të saldimit dhe pajisjeve përcjellëse.
- Respekton orarin e punës si dhe me disiplinë, kryen punët e dhëna nga prijësi i ekipit apo ndonjë epror tjetër në sistemin ku është caktuar të punoi. Zbaton të gjitha rregullat e sigurisë.
- I përgjigjet çdo kohe thirrjes për intervenim dhe të vazhdoj punën sipas nevojës edhe pas orarit të rregullt.
- Kryen edhe pune tjera me kërkesën e eproreve të tij (saldim me gaz – CO2 apo me hark elektrik me elektrodë)

Kualifikimet

- Të jetë saldues i certifikuar sipas standardit 9606-1 për saldim me argon. Të ketë përfunduar shkollën e mesme, të jetë i certifikuar si dhe të ketë një (1) vite përvojë pune në profesion. Aftësi profesionale, Aftësi që të arrij afate kohore. Aftësi për pune ekipore.

Saldues me Gaz (5 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

- Bartësi i këtij vendi të punës duhet të njohë mirë karakteristikat teknike të saldimit për montimet dhe stabilimentet si dhe udhëzimet për punë, të bashkëpunoj njëjtë me profilet tjera teknike.
- Në kryerjen e punëve është kryesisht i pavarur por edhe përgjegjës për kualitetin e punës së kryer.
- Punon rreth kryerjes së detyrave të përditshme në lëmin e saldimit me gaz dhe hark elektrik.
- Saldimi me gaz dhe hark të llojeve të caktuara të tegelave dhe në pozitat e caktuara të saldimit.
- Saldimi me gaz, mbushje, pikja, shpuarja dhe zgjerimi i vrimave me gaze.
- Saldimi i konstruksionit të çelikut, saldimit dhe gypave të ndryshëm të instalimit që nuk janë të nënshtruar presionit të lartë. Është përgjegjës drejtpërdrejtë për kualitetin e saldimit të kryer dhe është i pavarësuar në zgjidhjen adekuate të llojit të elektrodës si dhe parametrave tjerë për saldim elektrik. Është përgjegjës për manipulimin e rregullt me aparat për saldim me gaze dhe hark elektrik dhe për gjendjen teknike të tij dhe mjeteve dhe veglave për saldim si dhe për ruajtjen dhe për deponimin e tyre pas kryerjes së punës

Kualifikimet

- Të jetë saldues i certifikuar sipas standardit 9606-1 për saldim me gaz. Të ketë përfunduar shkollën e mesme, të jetë i certifikuar si dhe të ketë një (1) vite përvojë pune në profesion. Aftësi profesionale, Aftësi që të arrij afate kohore. Aftësi për pune ekipore

KEK-u fton të gjithë të interesuarit, ne veçanti kandidatët femra dhe nga komunitetet pakicë, të aplikojnë për pozitat e publikuara

Për me shume informata për pozitat e lartpërmendura vizitoni ueb faqen: www.kek-energy.com, ikona 'Shpallje' dhe mund ta shkarkoni Aplikacionin për pozitën që dëshironi të aplikoni.

Vërejtje: Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

1. Forma e aplikacionit të shkarkuar nga webfaqja e KEK-ut, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online të vegjëza: "Ngarko formularin për aplikim – të plotësuar"
2. Të gjitha dëshmitë për kualifikimin tuaj (diploma, certifikata me standardin ISO 9606, dëshmitë për trajnime etj.) i skanoni në një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe pastaj i ngarkoni në aplikimin online të vegjëza "Ngarko dëshmitë e kualifikimit"
3. Të gjitha dokumentet që dëshmojnë përvojën tuaj (vërtetimet dëshmitë nga trusti etj.), i skanoni në një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe i ngarkoni në vegzën: "Ngarko dëshmitë për përvojë".

Dokumentet pas afatit nuk do të pranohen ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen. Aplikantët të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës duhet të kenë leje qëndrimi në Kosovë. Kontrata e punës për të punësuarit për pozitën e zgjedhur do të jetë 1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj. Kandidatët e suksesshëm do të sistemohen në pozitat e lira sipas kërkesave nga divizionet operative të KEK-ut sipas kësaj shpallje. Nëse tregojnë performancë të mirë ata/ato do të sistemohen në vendin e punës për 3 (tre) vite nga dita e kontratës së parë dhe nuk kanë të drejtë ri-sistemimi në vend tjetër të punës.

Testimi do të bëhet në formë elektronike ashtu që vlerësimi do të jetë automatik. Procesi i testimit dhe intervistimit për kandidatët e suksesshëm me qëllim të transparencës do të monitorohet nga kamerat.

Prishtinë, 26.07.2023,

Data e aplikimit deri më 10.08.2023 ora 24:00

Divizioni i Burimeve Njerëzore

